

Sfida 25

SHTATOR 2007

Aftesia e Kufizuar dhe Zhvillimi



Vizita në Shqipëri, 2007

Jam kthyer në shtëpi, në Irlandë tashmë me kujtime shumë të dashura për vizitën time dhe njerëzit që takova, dashamirësinë e tyre.

Mary Keogh

Konsulente për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe zhvillimit

Vizion i të ardhmes: Aftësia e kufizuar në programet e zhvillimit



Enisa Zifla,
 vajza që nuk rresht se
 kerkuari nga vetja dhe te
 tjeret për t'u integruar në
 jetën sociale



Bledi Sulçe:

Karrigia me rrota më dha mundësi të rishoh botën...

Është e dyta karrigë me rrota që ai përfiton në bazë të projektit të FSHDPAK për pajisjen e personave me aftësi të kufizuara me materiale ndihmëse për lëvizje të financuar prej Vodafone Foundation Albania.

Në këtë numër

Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi

Faqe 3

Vizita në Shqipëri 2007

Jam kthyer në shtëpi, në Irlandë tashmë me kujtime shumë të dashura për vizitën time dhe njerëzit që takova, dashamirësinë e tyre.

Faqe 4

Vizion i të ardhmes: Aftësia e kufizuar në programet e zhvillimit Ngrihet pranë Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDPAK) grupi i këshilluesve – persona me aftësi të kufizuar dhe familjarë të tyre.

Faqe 6

Avokati dhe lobim më cilësor dhe rezultativ për nxitjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar

Faqe 8

Dita e 1 qershorit në Korçë

“Le të festojmë së bashku”

Faqe 10

Vodafone Foundation Albania: Këtë vit dyfishojmë fondin për prodhimin e karrigeve me rrota

Faqe 12

Bledi Sulçe: Karrigia me rrota më dha mundësi të rishoh botën....

Faqe 14

Persona me aftësi të kufizuar, prinder dhe familjare pranë Qendres së Zhvillimit të Shansëve të Barabarta, në mbështetje të problematikes së Aftësisë së Kufizuar

Faqe 15

Invalidët gëzojnë të drejtën e përjashtimit nga taksat doganore të pajisjeve ndihmëse dhe mjeteve lëvizëse, të cilat lehtësojnë lëvizjen e tyre

Fq 16

Enisa Zifla, vajza që nuk rresht se kerkuari nga vetja dhe të tjeret për t'u integruar në jetën sociale

Faqe 19



Sfida 25

Revistë e përtremuajshme

Financuar nga:

Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Swedish Helsinki Committee

for Human Rights

Bashkëpunëtorë:

Bardhylka KOSPIRI

Narbis BALLHYSA

Erjona MINKA

Entila ZYBA

Brikena DEMIRAS

Sonila CUMURATI

Edlira GRABOVA

Shoqata e të verbërve të Shqipërisë

Design and Layout
Grafika ELZANA

Adresa:

Rr.: “A. Z. Çajupi”, / (Bogdani)
Nr. 15 / kati III/ Tiranë

Tel/Fax.: +355 4269426

e-mail: adrf@albmail.com

www.adrf.org.al

www.adrf.org.al

Aftesia e Kufizuar dhe Zhvillimi

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) dhe Mobility International USA (MIUSA) me mbështetjen financiare të USAID, zhvilluan në datë 18 – 19 Qershor 2007 në ambientet e Tirana International Hotel takimin dy ditor “Krijimi i një komuniteti gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara” me përfaqësues të shoqërisë civile, organizata të fushës së aftësive të kufizuara, organizata të vendit dhe të huaja të fokusuar në programe zhvillimi, donatore të vendit dhe të huaj, përfaqësues të komunitetit të biznesit, të cilët kanë ekspertizë dhe njohuri në fushën e aftësive të kufizuara si dhe kanë ofruar në vazhdimësi partneritet serioz në implementimin e programeve për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Kjo iniciativë e FSHDPAK në bashkëpunim me MIUSA synoi të gjenerojë një debat konstruktiv ndërmjet pjesëmarrësve për vlerësimin e aftësive të kufizuara në kuadër të projekteve dhe programeve të zhvillimit. Pjesëmarrësit ndanë eksperiencat dhe njohuritë e tyre për çështjet e aftësive të kufizuara si dhe diskutuan mundësitë e bashkëpunimit për të promovuar dhe mbështetur aftësinë e kufizuara në drejtim të zhvillimit sepse ende në Shqipëri personat me aftësi të kufizuara janë të përjashtuar nga projektet dhe programet e zhvillimit.

Tashmë aftësia e kufizuara edhe në Shqipëri është një çështje që nuk duhet të perkase vetëm organizatave të aftësive të kufizuara, individëve me aftësi të kufizuara por ajo duhet të behet pjesë e të gjitha politikave dhe programeve të zhvillimit të organizatave jofitimprurese dhe institucioneve shtetërore duke synuar përfshirje të plote të personave me aftësi të kufizuara në komunitet.

Ky grupim do të jetë baza e një koalicioni në Shqipëri “Aftësia e Kufizuara dhe Zhvillimi”. Koalicioni do të jetë një zë i fuqishëm dhe shumplanësh për të mundësuar integrimin e çështjeve të aftësive të kufizuara në politikën dhe programet e zhvillimit të vendit.

Në përfundim të takimit dy ditor pjesëmarrësit nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi.



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

1. Ne, organizatat/individët nënshkrues të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, pranojmë të punojmë sëbashku, në koalicion, me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për të çuar më tej dhe për të mbështetur modelin e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e punës sonë.

2. Ne pranojmë të punojmë sëbashku për aktivitete të përbashkëta për të promovuar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e zhvillimit. Këto aktivitete përfshijnë fushata lobuese, aktivitete advokacie, shkëmbim informacioni dhe trainime.

3. Ne njohim eksperiencat dhe njohuritë e çdo organizate/individit në këtë grup.

4. Ne pranojmë të punojmë sëbashku në frymën e mirëkuptimit dhe të mësuarit prej njëri-tjetrit.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi deri tani është nënshkruar nga 30 përfaqësues të organizatave dhe institucioneve pjesë e koalicionit “Aftësia e Kufizuara dhe Zhvillimi”

Vizita në Shqipëri, 2007

Jam kthyer në shtëpi, në Irlandë tashmë me kujtime shumë të dashura për vizitën time dhe njerëzit që takova, dashamirësinë e tyre.

Udhëtova në Shqipëri në qershor 2007 për të bashkëpunuar me Mobility International USA (MIUSA) dhe Fondacionin Shqipëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDPAK). Kolegë të mi në Irlandë, të cilët kishin punuar në Shqipëri më parë, më kishin thënë gjëra të mira rreth udhëtimeve të tyre në Shqipëri. Si person me aftësi të kufizuar, një aspekt shumë i rëndësishëm i udhëtimit, kur unë shkoj në vende të ndryshme, është gjithmonë të paturit akses. Parashikimi i gjërave dhe planifikimi i shkëlqyer nga ana e FSHDPAK bëri të mundur që qëndrimi i im të ishte shumë i rehatshëm.

Gjatë 10 ditëve të qëndrimit, ne punuam në shumë aktivitete të ndryshme dhe takuam shumë persona të mrekullueshëm nga projekte të financuara nga USAID, Organizata për Persona me Aftësi të Kufizuar, OJF-ë dhe komuniteti i aftësisë së kufizuar. Fokusi kryesor i punës tonë ishte të diskutim mbi rrugët për të promovuar praktikatat përfshirëse të zhvillimit. Ne zhvilluam takime me shumë projekte si Kryqi i Kuq, Opportunity Albania,

Forecast dhe patëm diskutime shumë positive lidhur me hapat praktikë që ata mund të ndërmarrin për të siguruar se personat me aftësi të kufizuar përfshihen në punën që ata bëjnë.

Mund të veçoj disa arritje gjatë qëndrimit tim në Tiranë.

Për mua, dy aktivitetet më të rëndësishme në të cilat ne u fokusuam ishin: Trainimi i Këshilluesve për Zhvillimin e Çështjeve të Aftësisë së Kufizuar dhe Koalicioni i Zhvillimit dhe Çështjeve të Aftësisë së Kufizuar, të cilët janë hapa të rëndësishëm për të sjellë ndry-



Si person me aftësi të kufizuar, një aspekt shumë i rëndësishëm i udhëtimit, kur unë shkoj në vende të ndryshme, është gjithmonë të paturit akses. Parashikimi i gjërave dhe planifikimi i shkëlqyer nga ana e FSHDPAK bëri të mundur që qëndrimi i im të ishte shumë i rehatshëm.

shime të qëndrueshme për personat me aftësi të kufizuar. Promovimi i praktikave, që përfshijnë personat me aftësi të kufizuar, është shumë vital për integrimin e personave me aftësi të kufizuar në komunitet dhe në shoqëri. Për këtë qëllim, është shumë e rëndësishme që ky mesazh t'iu transmetohet si personave me aftësi të kufizuar si dhe atyre pa aftësi të kufizuar.

Trainimi i Këshilluesve i cili u zhvillua në disa ditë, iu dha si personave me aftësi të kufizuar dhe atyre pa aftësi të kufizuar mundësinë për të zhvilluar aftësi lidhur me paraqitjen e mesazhit për zhvillimin përfshirës.

Një grup burrash dhe grash me entuziazëm të jashtëzakonshëm ishin të pranishëm në zyrat e FSHDPAK-së duke mësuar dhe ndarë njohuritë e tyre për aftësinë e kufizuar dhe zhvillimin përfshirës.



Në fakt, trainimi ishte vetëm fillimi i një udhëtimi më të gjatë.



I uroj secilit pjesëmarrës në trainim fat të mbarë në përpjekjet e tyre në të ardhmen.

Nga perspektiva e një komuniteti më të gjerë, takimi dy-ditor u mbajt për të diskutuar rëndësinë e Koalicionit të Zhvillimit dhe Çështjeve të Aftësisë së Kufizuar. Duke patur një grup kaq të gjerë, i cili përfshin: komunitetin e biznesit, agjencitë e ndihmës, organizata jofitimpruese të aftësisë së kufizuar, do të thotë se aftësia e kufizuar nuk është vetëm një përgjegjësi e komunitetit me aftësi të kufizuar.

Pjesëmarrja në të dyja ditët ishte e shkëlqyer dhe idetë e dhëna nga pjesëmarrësit ishin një hap i rëndësishëm për të ndërthuar në mënyrë efektive bashkëpunimin mbi çështjet e zhvillimit dhe aftësisë së kufizuar. Një pikë tjetër shumë e rëndësishme që u trajtua ishte vështirimi i perspektivës kombëtare krahas asaj ndërkombëtare. Takimi dy-ditor përfundoi me marrëveshjen për të ndërthur hapat e tjerë në ndërtimin e

koalicionit dhe FSHDPAK pranoi të koordinonte aktivitetet përkatëse në fillim të kësaj faze.

Jam kthyer në shtëpi, në Irlandë tashmë me kujtime shumë të dashura për vizitën time dhe njerëzit që takova, dashamirësinë e tyre, veçanërisht duke më siguruar mua një automjet për transportin tim, dhe natyrisht sëbashku me automjetin dhe një shofer të mrekullueshëm. I uroj FSHDPAK-së dhe të gjithë kolegëve të tyre fat të mbarë në punën e tyre të ardhshme me çështjet e zhvillimit dhe aftësisë së kufizuar.

Dhe një gjë të fundit, MIUSA, për të cilën unë punova, ka një pasuri të madhe njohurish në fushën e praktikave përfshirëse të zhvillimit dhe ka burime të shkëlqyera në website-in e tyre. Nëse nuk e keni vizituar akoma, ju lutem bëjeni: <http://www.miusa.org>

Mary Keogh

Konsulente për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe zhvillimit

Ngrihet pranë Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDDPAK) grupi i këshilluesve – persona me aftësi të kufizuar dhe familjarë të tyre.

Vizion i të ardhmes:

Aftësia e kufizuar në programet e zhvillimit

Në kuadrin e projektit ‘Ndërtimi i një komuniteti Përfshirës’, të organizuar nga FSHDDPAK në bashkëpunim me MIUSA (Mobility International USA), mbështetur nga USAID, një grup personash, individë aktive me aftësi të kufizuar dhe drejtues me eksperiencë të shoqatave të prindërve të fëmijëve me AK u mbledhën së bashku në një aktivitet të veçantë – krijimin e një grupi këshilluesish me mision për të bashkëpunuar dhe nxitur organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare të zhvillimit për ta përfshirë problematikën e aftësisë së kufizuar në programet e tyre të zhvillimit. Në cilësinë e trajnuesëve Cara Galbraith dhe Mary Keogh, përfaqësues të MIUSA, punuan për ngritjen e kapaciteteve të mëtijshme të pjesëmarrësve për t’i bërë të aftë për një bashkëpunim cilësor me agjensitë ndërkombëtare të zhvillimit.

Gjate dy ditëve të trajnimit, ato ofruan informacionin dhe njohuritë e duhura për pjesëmarrësit, të domosdoshme për ta bërë sa më eficient rolin e tyre si këshillues në influencimin pranë agjensive të zhvillimit. Pjesëmarrësit u njohën fillimisht me Konventën e Nderkombëtare mbi të



Në cilësinë e trajnuesëve Cara Galbraith dhe Mary Keogh, përfaqësues të MIUSA, punuan për ngritjen e kapaciteteve të mëtijshme të pjesëmarrësve për t’i bërë të aftë për një bashkëpunim cilësor me agjensitë ndërkombëtare të zhvillimit. Gjate dy ditëve të trajnimit, ato ofruan informacionin dhe njohuritë e duhura për pjesëmarrësit, të domosdoshme për ta bërë sa më eficient rolin e tyre si këshillues në influencimin pranë agjensive të zhvillimit.

Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Më tej ofrimi i modeleve të procesit të avokati-lobimit në shërbim të zgjidhjes së çështjes së gjetjes së hapësirave të përfshirjes së problematikës së AK në programet e zhvillimit dhe ndërtimit të një bashkëpunimi të qëndrueshëm, u prezantuan nga trajnueset duke theksuar rendesinë e këtij hapi në ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit.

Aktiviteti u zhvillua më tej në grupe pune, ku pjesëmarrësit zbatuan njohuritë e përfituara në disa raste konkrete studimore, të ofruara nga trajnuesit, duke kaluar në të gjitha hallkat e një procesi avokatie e lobimi – si të kontaktojmë me organizatën, çfare shpresojmë të arrijmë gjatë bisedës, cilat janë rezultatet e pritëshme, përgatitja e një plani me pyetjet që do të bëhen, cila pjesë e legjislacionit shqiptar i mbështet këto përpjekje.

Pjesëmarrësit e grupit të këshilluesve, të asistuar nga trajnueset e MIUSA morën pjesë në takime direkte me përfaqësues të programeve konkrete të agjensive të zhvillimit për të gjetur dhe diskutuar së bashku për hapësirat e mundëshme të përfshirjes dhe ndërthurjes së problematikës së aftësisë së kufizuar me programet e tyre.



Ofrimi i modeleve të procesit të avokati-lobimit në shërbim të zgjidhjes së çështjes së gjetjes së hapësirave të përfshirjes së problematikës së AK në programet e zhvillimit dhe ndërtimit të një bashkepunimi të qëndrueshëm, u prezantuan nga trajnueset duke theksuar rëndësinë e këtij hapi në ndërtimin e marrëdhënieve të bashkepunimit.

Gjatë ditëve në vazhdim, pjesëmarrësit e grupit të këshilluesve, të asistuar nga trajnueset e MIUSA morën pjesë në takime direkte me përfaqësues të programeve konkrete të agjensive të zhvillimit për të gjetur dhe diskutuar së bashku për hapësirat e mundëshme të përfshirjes dhe ndërthurjes së problematikës së aftësisë së kufizuar me programet e tyre. U kontaktuan përfaqësues të disa programeve të USAID-Shqipëri si: Junior Achievement, American Red Cross, Word Learning, PSHM, EDEM, ku pasi u degjua prezantimi i programeve të tyre u orientuan për hapësirat e bashkëpunimit. Këto takime direkte ndihmuan pjesëmarrësit, si përfaqësues të OJF të aftësisë së kufizuar, për të patur një vizion më të qartë dhe për të qënë më konkretë në projektet e tyre bashkëpunuese me agjensitë e zhvillimit në të ardhmen.

Bardhylla Kospiri
Koordinatorë e Programit të Avokatisë, pranë FSHDPAK

Avokati dhe lobim më cilësor dhe rezultativ për nxitjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar

Në kuadrin e projektit “Përmirësimi dhe mbrojtja e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar”, me mbështetjen e USAID, u zhvilluan trajnimet “Strategjia Kombëtare e PAK - E drejta për përfshirje dhe roli i PAK dhe shoqatave të AK në monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar në qytetet Shkoder, Elbasan, Vlore, Tirane, Korçe e Durrës, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave të personave me aftësi të kufizuar. Trajnimet synuan në ngritjen e nivelit të avokatise për rritjen e pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të organizatave të personave me aftësi të kufizuar (OPAK) në vendimarrje lokale dhe kombëtare si edhe në vazhdimin e procesit të zhvillimit të iniciativave advokuese në të gjashtë rajonet e mësipërme për të siguruar një dialog të vazhdueshëm konstruktiv dhe pjesëmarrjen e OPAK në proceset e vendimarrjes në nivel lokal dhe kombëtar.

Në trajnime morën pjesë rreth 92 persona, përfaqësues të organizatave të të gjithë spektrit të aftësisë së kufizuar, organizata të pavarura ose degë të organizatave kombëtare.

Trajnimet synuan në ngritjen e nivelit të avokatise për rritjen e pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të organizatave të personave me aftësi të kufizuar (OPAK) në vendimarrje lokale dhe kombëtare si edhe në vazhdimin e procesit të zhvillimit të iniciativave advokuese në të gjashtë rajonet e mësipërme për të siguruar një dialog të vazhdueshëm konstruktiv dhe pjesëmarrjen e OPAK në proceset e vendimarrjes në nivel lokal dhe kombëtar.



Trajnimet u drejtuan nga trajnues, persona me aftësi të kufizuar, të përzgjedhur nga grupi i trajnerëve të kualifikuar, pranë FSHDPAK.

Gjatë zhvillimit të trajnimeve u vu re një nivel jo i njëjtë, shpesh edhe i pamjaftueshëm, i njohurive të pjesëmarrësve në

fushën e legjislacionit të aftësisë së kufizuar.

Të gjithë pranuan se kjo mangësi duhet plotësuar si domosdoshmëri në përpjekjet e tyre për mbrojtjen e të drejtave dhe ndërtimin e dialogut të qëndrueshëm në nivel vendor dhe qendror për zbatimin e

legjislacionit. Në mënyrë të veçantë pjesëmarrësit u njohën me përgjegjësitë e pushtetit vendor në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar duke e vlerësuar këtë si hap të domosdoshëm në orientimin

Të gjithë pjesëmarrësit e trajnimeve u shprehën se janë të domosdoshme informacione të tilla për përditësimin e zhvillimeve në fushën e aftësisë së kufizuar, sidomos në ndjekje të ndryshimeve legjislative në këtë fushë.



Prezantimi i mënyrave dhe mjeteve për të zhvilluar një proces avokatie e lobimi të suksesshëm me përfaqësues të pushtetit vendor për zgjidhjen e një çështjeje konkrete u vlerësua si një ndihmesë për rezultate pozitive në zgjidhjen e problematikave të shumta në marrëdhënie me pushtetin vendor.



dhe mbështetjen e kërkesave të tyre. Gjithashtu prezantimi i mënyrave dhe mjeteve për të zhvilluar një proces avokatie e lobimi të suksesshëm me përfaqësues të pushtetit vendor për zgjidhjen e një çështjeje konkrete u vlerësua si një ndihmesë për rezultate pozitive në zgjidhjen e problematikave të shumta në marrëdhënie me pushtetin vendor.

“Më duhet të trokas shpesh në dyert e bashkisë Tranë për probleme të ndryshme – thote L.Rugji, kryetare e shoqatës “Shpresë e Dashuri”, Tiranë- dhe informacioni për përgjegjësitë e pushtetit vendor në Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, me të cilat u

njoha më mirë gjatë trajnimit, më bejnë që të jem më e sigurtë dhe e mirëorientuar në kërkesat e mia, gjithashtu jam më e qartë për mënyrat se si duhet të drejtohem dhe se ç’mjete duhet të përdor në takimet lobuese që zhvilloj “ Në përgjithësi të gjithë pjesëmarrësit e trajnimeve u shprehën se janë të domosdoshme informacione të tilla për përditësimin e zhvillimeve në fushën e aftësisë së kufizuar, sidomos në ndjekje të ndryshimeve legjislative në këtë fushë.

Bardhylka Kospiri
Koordinatorë e Programit të Avokatisë,
pranë FSHDPAK

Dita e 1 qershorit në Korçë

„Le të festojmë së bashku“

Kete vit me rastin e Dites Nderkombetare te Femijeve, 1 Qershorit, Organizata Gjermane per Bashkepunim Teknik - GTZ ne kuader te projektit “Mbeshtetja e femijeve me aftesi te kufizuar” dhe FSHDPK ne vazhden e bashkepunimit te tyre ne fushen e aftesise se kufizuar ndermorren organizimin e nje aktiviteti festiv me femijet dhe te rinjte e qytetit.

„Le te festojme sebashku” ky ishte lajtmotivi i aktivitetit te perbashket te GTZ-se dhe Fondacionit Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar (FSHDPK) zhvilluar me 1 Qershor ne qytetin e Korçes.

Kete vit me rastin e Dites Nderkombetare te Femijeve, 1 Qershorit, Organizata Gjermane per Bashkepunim Teknik - GTZ ne kuader te projektit “Mbeshtetja e femijeve me aftesi te kufizuar” dhe FSHDPK ne vazhden e bashkepunimit te tyre ne fushen e aftesise se kufizuar ndermorren organizimin e nje aktiviteti festiv me femijet dhe te rinjte e qytetit.

Si projekti i GTZ-se ashtu edhe programet e FSHDPK-se kane ne fokusin e perbashket te aktiviteteve te tyre integrimin e femijeve me aftesi te kufizuar mendore e fizike ne shoqeri permes promovimit te te drejtave te tyre per arsim, formim profesional, aktivitete sociale dhe kulturore.



Organizimi i ketij aktiviteti synoi qe permes nje dite sa me festive dhe argetuese per femijet, se pari te ftohen dhe perfshihen edhe femije me aftesi te kufizuar shpesh per nje teresi aresyesh te privuar nga keto te drejta e liri dhe se dyti te mund te transmetohen mesazhe ndergjegjesuese dhe sensibilizuese si per institucionet edhe per shoqerine per te ndikuar sado pak ne permiresim e qendrimeve te komunitetit te qytetit dhe te autoriteteve pergjegjese per t'u ofruar ketyre femijeve nje jete me te mire socialo-kulturore.

I qershori kjo dite kushtuar mbare femijeve, mbart ne vetvete nje simbolike te rendesishme per te percjelle mesazhe lirie e respektimi per te drejtat e femijeve e nje bashkejetese harmonike per te

gjithe. Te shtyre nga ky moment, organizimi i ketij aktiviteti synoi qe permes nje dite sa me festive dhe argetuese per femijet, se pari te ftohen dhe perfshihen edhe femije me aftesi te kufizuar shpesh per nje teresi

aresyesh te privuar nga keto te drejta e liri dhe se dyti te mund te transmetohen mesazhe ndergjegjesuese dhe sensibilizuese si per institucionet edhe per shoqerine per te ndikuar sado pak ne permiresim e qendrimeve te komunitetit te qytetit dhe te autoriteteve pergjegjese per t'u ofruar ketyre femijeve nje jete me te mire socialo-kulturore.

Atmosfera festive u perqendrua ne parkun e qytetit i cili qe ne oret e para te mengjesit u mbush ne çdo kend te tij me punimet artistike shumengjyreshe te femijeve me stenda animimi, pikturimi e organizimi lojrash, muzike etj.

Me mbeshtetjen dhe gatishmerine e Bashkise se Korçes veçanerisht te Kryetarit te Bashkise dhe stafit te tij, u ngrit kendi „ndergjegjesues” per te drejtat e femijeve dhe te rinjve me aftesi te kufizuar. Te ftuar ishin te rinjte e Qendres Atelie te Zhvillimit te Korçes ku paraqiten punimet e tyre artistike te prodhuara nga vete ata ne kete qender. Krahas punimeve te ndryshme spikasnin edhe pikturat e shumta te te riut me aftesi te kufizuar Ervin Theodhosi mes gjetjeve origjinale e shumengjyreshe si shprehje e botes dhe personalitetit te tij.

Nje kuptim te veçante gjate kesaj feste por edhe fushate ndergjegjesuese njekohesisht pati edhe prania e Kryetarit te Bashkise z. Niko Peleshi i cili me perkushtimin e tij dhe kohen e gjate qe kaloi mes femijeve per vete figuren qe perfaqeson,



Krahas punimeve te ndryshme spikasnin edhe pikturat e shumta te te riut me aftesi te kufizuar Ervin Theodhosi mes gjetjeve origjinale e shumengjyreshe si shprehje e botes dhe personalitetit te tij.

transmetoi qarte rendesine e gjithperفشirjes, integritimit dhe vemendjes se madhe qe meriton ky grup femijesh e te rinjsh te prekur nga problemet e aftesise se kufizuar.

Sigurisht qe mes nje atmosfere te gjalle e festive te femijeve e shkelqimit te diellit te asaj dite nuk munguan as lulet. Ne menyre simbolike u shiten vazo me lule shoqeruar me mesazhe sensibilizimi e urimi per gjithepershirjen e femijeve: Ndhimo sot, per nje te neserme me te mire per femijet me aftesi te kufizuar. Te ardhurat nga shitja e vazove te luleve shkuan ne ndihme te femijeve me aftesi te kufizuar te Qendres se Zhvillimit Korçe.

Te tjere mesazhe te shkruar qe u percollen gjate festes ishin „Sebashku per te mbrojtur te drejtat e femijeve -Gezuar Diten e Femijeve” apo “Femije = E ardhme, Le te krijojme nje te

Te tjere mesazhe te shkruar qe u percollen gjate festes ishin “Se bashku per te mbrojtur te drejtat e femijeve -Gezuar Diten e Femijeve” apo “Femije = E ardhme, Le te krijojme nje te ardhme te barabarte per te gjithë”.

ardhme te barabarte per te gjithë”.

Duke uruar qe ky aktivitet t’ja kete arritur sado pak qellimit tone, besojme dhe urojme qe ne kete dite femijet me aftesi te kufizuar te jene ndjere pjese e qytetit te tyre si dhe njerezit dhe komuniteti i qytetit me te ndjeshem ndaj vemendjes e nevojës per zgjidhjen e problemeve qe ata kane.

Eriona Minka
Koordinatorë Programi
GTZ

Vodafone Foundation Albania:

Këtë vit dyfishojmë fondin për prodhimin e karrigeve me rrota

Një nga shembujt e rralle të bashkëpunimit mes komunitetit të biznesit me shoqërinë civile në vend.


Person me aftësi të kufizuar, më thua? Ka veshtiresi të dale në rrugë pasi shoqëria i ka vënë barriera? E pse duhet që unë një lexues i shëndetshëm të interesohem për këtë çështje që nuk bën pjesë aspak në listen e punëve të mia? Përgjigja është e thjeshtë! Sepse të gjithë jemi më pak apo më shumë të cenueshëm dhe jetët tona herët a vonë mund edhe preken nga kjo çështje. Në rrethin familjar, në rrethin e të njohurve tanë, në pallatin ku jetojmë, në rrugë, kudo shoqërohem edhe nga njerëz me aftësi të kufizuar. Porse ndihma që ne mund të japim për t'u lejuar të jetojnë jetën e tyre, që është një dhe e vetme, duhet të nisë nga mundësia për lëvizje. Si mund ti japim mundësi një personi me aftësi të kufizuar për lëvizje pa një mjet, karrocë? Është mundësia që i ndihmon ata të dalin jashtë mureve të shtëpise, të takojnë njerëzit e afërt, njerëz të rinj, të shkojnë në bibliotekë, të hapin horizontin e të fillojnë edhe një punë...nevojitet kaq pak për të ndryshuar aq shumë.

Është pikërisht ky reflektim që ben Fondacioni Vodafone Albania në financimin e projektit të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar për prodhimin e karrigeve me rrota, duke u ardhur në ndihmë komunitetit të këtyre njerëzve në nevojë. Ky përfaqëson një nga shembujt e rralle të bashkëpunimit mes komunitetit të biznesit me shoqërinë civile në vend.

“Në momentin e parë kur FSHDPAK u paraqit me një projekt propozim, ishim skeptikë për mundësitë e zbatimit cilësor të projektit, por njëkohësisht mjaft optimist përse i përket qëllimit dhe përfitimeve të komunitetit nga ky projekt. Kjo edhe për faktin se në Shqipëri nuk kishte eksperiencë në fushën e kontributit dhe bashkëpunimit me biznesin dhe shoqërisë civile. Por zbatimi me cilësi dhe evidentimi i impaktit që ky projekt kishte tek njerëzit në nevojë, bëri që kjo eksperiencë të pasohej nga katër projekte që

prej tre vjetësh vazhdojnë dhe jo vetëm vazhdojnë, por shtojnë edhe mundësitë financiare për to. Sivjet, kemi dyfishuar buxhetin e dhuruar për këto projekte, në mënyrë që të dyfishohet edhe prodhimi i karrigeve me rrota”, - na tregon Albi Greva, Drejtori Ekzekutiv i këtij fondacioni.

Biznesi mund të jetë një shembull shumë i mirë si financues i projekteve në të dobi të shtresave në nevojë. Shpesh kompanitë mëdha financojnë aktivitete të ndryshme, ditë të caktuara si të veçanta për një çështje specifike apo dhe ngjarje festive. Pjesa me



e madhe janë sporadike dhe të pa planifikuara për të ndihmuar përfituesit në një kuadër bashkëpunimi me efektivitet e afatgjatë. “Te gjithë në nuk e shohim dot atë “dritën” që u jep një karrige-dhuratë një individ në nevojë. Imajtoni t’i japësh mundësinë për levizje dikujt që ka ndënjur për vite me rradhe në shtëpi për të vetmen arsye se s’ka pasur një karrige me rrota, ose sepse ndihet i frikësuar, i paafte, ose thjesht nuk do të shihet në gjendjen e tij. Pikerisht këtu duhet ta shohim impaktin e madh, e të frymëzohemi për me shumë”, shpreh Grevë.

Vodafone Foundation Albania, i krijuar rishtaz nga kompania Vodafone Albania me qëllim për të përdorur fondet e kompanisë në mënyrë efektive, strategjike dhe efikase përfaqëson vetëm një shembull të mbështetjes së grupeve të vulnerabël dhe nevojat e tyre. Natyrisht, institucionet shtetërore janë gjithashtu përgjegjës. Shpesh sytë e këtij komuniteti i drejtohen shtetit, pasi mundësitë mungojnë apo përgjigjia nuk është pozitive përherë. Pasi sot biznesi, përveç misionit të tij përcësor, ka nevojë të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë edhe në këtë aspekt. “Problemet që shfaqen këtu janë të trashëguara nga mungesa e infrastrukturës, e kulturës, e mjedisit. Në kemi nevojë të zhvillohemi si shoqëri në mënyrë të shëndetshme, në çdo shtresë dhe çdo pjesë të komunitetit. Dhe këtu biznesi ka një rol të jashtëzakonshëm, sepse është ai që është i interesuar në zhvillim të shoqërisë. Është si të thuash të rregullojmë shtëpitë tona dhe të harrojmë se i kemi shkallët e papastra, apo lulishten e shkatërruar përpara. Në këtë

Vodafone Foundation Albania, i krijuar rishtaz nga kompania Vodafone Albania me qëllim për të përdorur fondet e kompanisë në mënyrë efektive, strategjike dhe efikase përfaqëson vetëm një shembull të mbështetjes së grupeve të vulnerabël dhe nevojat e tyre.



“Ajo që mendoj se bën ndryshimin është shembulli i mirë. Dhe projektet që në financojmë kanë impakte të dukshme, të cilat numërojnë mijat njerëz që përfitojnë. Por ka shumë të tjera që presin për këto kujdes. Prandaj ne duhet të jemi me shumë, të mendojmë me shumë”.

aspekt edhe biznesi ka nevojë të tregojë rolin e tij të përgjegjshmerisë, të jetë i kujdeshem për mjedisin ku jeton, njerëzit e komunitetin të cilët i kanë sytë drejtuar edhe tek ai”, shton Albi Grevë. E ndërsa shembujt e bizneseve të përgjegjshëm në këtë aspekt janë ende të pakta, ky fondacion përfaqëson një eksperiencë që mund të ndiqet edhe nga të tjerë. “Ajo që mendoj se bën ndryshimin është shembulli i mirë. Dhe projektet që në

financojmë kanë impakte të dukshme, të cilat numërojnë mijat njerëz që përfitojnë.

Por ka shumë të tjera që presin për këto kujdes. Prandaj ne duhet të jemi me shumë, të mendojmë me shumë”.

Ecuria e projekteve deri tani me FSHDPAK, është një dëshmi për vazhdimësinë e tyre.

“Në themi që kemi një partner që është i zoti të mbajë premtimet, një partner që bën përpjekjet maksimale për të bërë maksimumin e vet, në arritjen e rezultateve”, thekson Grevë.

Dyfishimi i fondeve për projektin, sipas tij do të thotë dyfishim të besimit për menaxhimin e nevojave të komunitetit nga fondacioni. “Në e dimë që nevojat janë shumë të mëdha, por duke dyfishuar buxhetin dhe objektivat e projektit, mendojmë se mund të realizojmë më mirë atë që njerëzit kanë nevojë”, thotë Grevë.

**Brikena Demiras
gazetare**

Bledi Sulçe:

Karrigia me rrota më dha mundësi të rishoh botën....

“Pasi mora karrigen e parë me rrota, jeta ime ka qenë më e pavarur”

Me këtë fjali e nis përshkrimin për jetën e tij, Bledi Sulçe, një 25 vjeçar nga Burreli. Ai është person me aftësi të kufizuar që prej 12 vjetësh, kur u aksidentua në vitin 1995. Karrigia e parë u ble prej babait të tij rreth katër muaj pas aksidentit dhe shërbente thjesht për të lëvizur nëpër shtëpi. Vetëm dy vjet më pas arriti të siguronte një karrige aktive që do t'i jepte lirinë për të dalë jashtë mureve të ngurta të shtëpisë. Menjëherë pas kësaj pasoi një kamp veror në Durrës ku mësoi teknikat për të kapërcyer pengesat në rrugë, për t'ju përshtatur infrastrukturës së keqe dhe të papërshtatshme të ndërtesave, trotuareve.

Është një djalosh tepër vital, me energji të admirueshme. Prej atij kursi një javor ka mësuar aq shumë sa që është bërë profesionist për të trajnuar të tjerë persona me aftësi të kufizuara që kanë nevojë. Edhe pse ka një makinë dhe mund të lëvizë me të kudo, pa karrigen e lëvizshme nuk bën dot. “Është njësoj si këmbët e mia, pa karrigen me makinë nuk mund të hysh kudo”, thotë Bledi.



Menjëherë pas kësaj pasoi një kamp veror në Durrës ku mësoi teknikat për të kapërcyer pengesat në rrugë, për t'ju përshtatur infrastrukturës së keqe dhe të papërshtatshme të ndërtesave, trotuareve.

E mban mend shumë mirë atë periudhë, kur për më shumë se 6 muaj kur nuk lëvizte dot fare. “Është jetë monotone, të rrish brenda katër mureve, të mos dalësh dot, të mos bësh asgjë, vetëm sheh televizor. Unë nuk rri dot, nuk është në karakterin tim”, thotë ai. Ishte vetëm 13 vjeç atëherë dhe kishte ëndrrat e veta. “Më pëlqente futbolla dhe boksi. Kam qenë në ekipin e të rinjve në Burrel, por pas

aksidentit i dhashë lamtumirën. Ikën ato ëndrra, morën fund. Tani, thashë me vete të shohim diçka tjetër”, tregon ai jo me pak keqardhje, sidomos për boksin. Futbolla kishte qenë më shumë një lojë fëmijësh, ndërsa boksi një qëllim në vetvete. Të dyja morën fund.

Bledi do të kërkonte mundësi të reja sportive, duke qenë një tip shumë sportiv. “Kisha parë edhe në televizor se njerëzit me aftësi

Është e dyta karrige me rrota që ai përfiton në bazë të projektit të FSHDPAK për pajisjen e personave me aftësi të kufizuara me materiale ndihmëse për lëvizje i financiar prej Vodafone Foundation Albania.

të kufizuara luanin basketboll, por më dukej më shumë si cirk, një gjë e pabesueshme. Por kur e pashë edhe vetë që mund të bëhej isha shumë i gëzuar. Mësova mbi teknikat e lojës dhe jam praktikuar derisa funksionoi komiteti paraolimpik, në 2001. Edhe pse jemi përpjekur ta rivëmë në jetë, por duhet të ribëhen edhe njëherë zgjedhjet. Të gjitha përpjekjet kanë qenë të dështuara”, thotë ai.

Është e dyta karrige me rrota që ai përfiton në bazë të projektit të FSHDPAK për pajisjen e personave me aftësi të kufizuara me materiale ndihmëse për lëvizje i financiar prej Vodafone Foundation Albania. Ai e vlerëson

si një kontribut shumë të mirë nga një kompani shumë e fuqishme që duhet të merret si shembull edhe nga biznese të tjera. “Është një ëndërr e prekshme dhe që ka shërbyer për të integruar shumë e shumë njerëz si unë në jetën e përditshme. Unë personalisht ndjehem i privilegjuar”, thotë ai. Bizneset mund të kontribuojnë edhe për arsimimin dhe punësimin e këtyre personave. Bledi pas shumë përpjekjesh e kërkimesh ka arritur të punësohet me kohë të pjesshme në organizatën World Vision, si receptionist. Kanë kaluar

“Është një ëndërr e prekshme dhe që ka shërbyer për të integruar shumë e shumë njerëz si unë në jetën e përditshme. Unë personalisht ndjehem i privilegjuar”, thotë ai.

vetëm dy muaj që kur e siguroi këtë punë, me mbështetjen e Fondacionit Shqiptar të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara. “E keqja është se vetë shteti që harton ligje nuk i

zbaton ato, sado të mira që i ka. Për shembull për punësimin, edhe pse çdo kompani është e detyruar në 25 persona të ketë një të punësuar me aftësi të kufizuara asnjë nuk e bën këtë, madje as kompanitë shtetërore”, revoltohet ai. Ka shumë miq e shokë të papunë, që shteti nuk u jep asnjë dorë dhe thotë se vetëm pa punë nuk rrihet. “Kur je i punësuar i jep një kuptim jetës, je më i integruar dhe ndihesh i barabartë. Aq më tepër kur punon me persona që nuk të përbuzin”, tregon dhe thith një cigare që sapo e ka nderur. Të ardhmen e sheh shumë thjesht...të vazhdojë punën që ka nisur, të trajtojë të tjerë njerëz me aftësi të kufizuara dhe të gëzojë ditët e tij. Edhe pse nuk ka shumë mundësi argëtimi, ashtu si edhe për të rinjtë e tjerë, mbasditet e lira pas punës, kthehet në Marikaj, aty ku jeton, takon miqtë dhe mikeshën e tij, pi kafën e zakonshme dhe pas darke bie të flerë për t’ia lënë sërish radhën një dite të re, ndoshta më të bukur se ajo që mbeti pas...

Brikena Demiras
Gazetare

Persona me aftësi të kufizuara, prinder dhe familjare pranë Qendres së Zhvillimit të Shanseve të Barabarta, në mbështetje të problematikes së Aftësisë së Kufizuara

Çdo të enjte, pranë Qendres së Zhvillimit të Shanseve të Barabarta Shkoder, zhvillohen takime me PAK prinder dhe familjare. Siç është bere e ditur tashme, prej me shume se nje viti, kjo qender, projekt i Fondacionit Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara; ofron asistence në qytetin e Shkodres, duke fokusuar veprimtarine dhe sherbimet e saj, në fushen e aftësisë së kufizuara.

Qe në fillimet e saj, qendra, ka shërbyer si qender burimore, informuese, trajnuese, orientuese duke patur në fokus të veprimtarisë së saj integrimin e personave

Takimet me rrjetin e prinderve perbejne disa nga pikat me te rendesishme te veprimtarise se Qendres se Zhvillimit te Shanseve te Barabarta, duke gene se ato vazhdimisht karakterizohen nga nje fryme mirekuptimi dhe bashkepunimi ndermjet te pranishmeve.

me aftesi te kufizuar ne ambiente gjithperfshirese si arsim, punesim etj.

Gjithashtu kjo qender siguron mbeshtetje dhe mbrojtje ligjore per personat me aftesi te kufizuar, te afermit dhe familjaret e tyre, duke siguruar ne te njejten kohe, respektimin e te drejtave dhe lirive themelore te njeriut.

Personat qe kane kerkuar ndihme prane saj, kane gjetur mirekuptim dhe bashkepunim prane stafit te qendres, i cili ofron sherbimet perkatese, ne mbeshtetje te problematikes se aftesise se kufizuar dhe personave te prekur. Takimet me rrjetin e prinderve perbejne disa nga pikat me te rendesishme te veprimtarise se Qendres se Zhvillimit te Shanseve te Barabarta, duke qene se ato vazhdimisht karakterizohen nga nje fryme mirekuptimi dhe bashkepunimi ndermjet te pranishmeve. Nga e enjtja ne te enjte, numri i pjesemarrsesve shtohet duke sjelle me vehte persona me aftesi te kufizuar, prinder dhe dashamires te cilet me deshire afrohen prane qendres sone.



Takimet koordinohen nga stafi i qendres, nderkohe qe ne saje te punes se bordit te prinderve, rrjeti i personave te interesuar, rritet nga dita ne dite. Jo pak here familjaret pjesemarrres shoqerohen nga femije apo te aferm me aftesi te kufizuara, te cilet ndjehen te perfshire si pjese aktive e qendres si per nga pjesemarrja ne debate dhe diskutime ashtu edhe ne mendimet dhe vleresimet, qe ofrojne gjate ketyre takimeve. Diskutimet ndermjet te pranishmeve zakonisht orientohen drejt tematikave me ne fokus te drejtat e personave me aftesi te kufizuara si:

- e drejta e te qenit i vleresuar dhe i respektuar
- e drejta per sherbime
- e drejta e mbrojtjes nga diskriminimi
- e drejta per te jetuar,

- e drejta per t'u arsimuar dhe per t'u pergatitur profesiona-lisht, etj.

Gjithashtu ne keto takime zhvillohen vazhdimisht diskutime si tema te vecanta per te cilat pak mund te ngrene zerin mbi problemet qe i shqetesojne dhe mbi te cilat mund te punohet e mund te kerkohen zgjidhje praktike, si p.sh:

- arsimimi i femijeve me aftesi te kufizuar te perfshire ne gjakmarrje
- regjistrimi i personave me aftesi te kufizuar ne zyren e punesimit
- kurset profesionale per personat me aftesi te kufizuar dhe trajnimet e kualifikimit, etj.

Te pranishmit, gjate takimeve pajisen rregullisht me paketa mbi aftesine e kufizuar dhe te drejtat e personave me aftesi te kufizuar, realizimi i se ciles, mundesohet nga FSHDPAK, literature, kjo mjaft e kerkuar si nga personat me aftesi te kufizuar ashtu dhe nga familjaret e tyre.

Edlira Grabova

*As/ Koordinator e Qendres se
Shanseve te Barabarta,
Shkoder, FSHDPAK*

Invalidët gëzojnë të drejtën e përjashtimit nga taksat doganore të pajisjeve ndihmëse dhe mjeteve lëvizëse, të cilat lehtësojnë lëvizjen e tyre

Bazuar në kërkesat e shumta të aplikuesve në Zyrat Ligjore të Programit të Asistencës Ligjore dhe Avokatisë për Personat me Aftësi të Kufizuar po trajtojmë në vijim, përcaktimet në legjislacionin shqiptar në lidhje me lehtësitë që gëzojnë invalidët dhe përjashtimin nga taksat doganore të pajisjeve ndihmëse dhe mjeteve lëvizëse në shërbim të tyre.

Në mbështetje të legjislacionit shqiptar, konkretisht Ligji nr. 7889, date 14.12.1994 "Për Statusin e Invalidit të Punës" (i ndryshuar) neni 8, ligji nr. 8098 datë 23.03.1996 "Për statusin e të Verbrit" neni 15, Ligji nr. 8626 datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" dhe Rregullores Nr. 29/1, Date 21. 3.2003 "Mbi kriteret dhe administrimin e

për tu pajisur ose jo.

4. kriteret e përfitimit, dokumentacioni dhe procedura janë të njëjta me ato që përcaktohen më poshtë.

Dokumentacioni që duhet të paraqitet nga invalidët në DRSSH (Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore) është si më poshtë

1. kërkesë personale,

pajisjeve te invalidëve (*ndryshuar me vendimin nr. 81, date 2.5.2003*) garantohet e drejta e çdo invalidi i cili gëzon respektivisht këto statuse për të përfituar, falas nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, mjetet e mëposhtme:

- a) mjete lëvizëse te thjeshta, mjete lëvizëse motorike (biçikleta, tricikla) përfshi dhe autovetura te përshtatura për invalidë,
 - b) pajisje te ndryshme ortopedike,
 - c) mjete ndihmese dëgjimore e pamore speciale,
 - d) mjete ndihmese kardiake etj.
- Sipas referimeve të mësipërme ligjore, **pajisjet të ndryshme ndihmëse përfitojnë kategoritë e mëposhtme;**

1. Mjete lëvizëse të thjeshta përfitojnë invalidët me gjendje shëndetësore që nuk lejon lëvizjen (ecjen) pavarësisht nga origjina e kësaj gjendjeje shëndetësore.
2. Mjetet ndihmëse kardiake (PACE-MAKER) përfitojnë invalidët kartiopatë me patologji të ritmit (sipas rekomandimit të klinikës kardiologjike).
3. Mjetet ndihmëse dëgjimore e pamore, përfitojnë invalidët me probleme të dëgjimit e të pamjes (sipas rekomandimit të klinikave përkatëse).
4. Pajisje të ndryshme ortopedike përfitojnë invalidët me frakturë të ekstremiteteve inferiore, coxarthroza, amputacione.

Ndërsa, kategoritë të cilat përfitojnë mjete lëvizëse motorike, janë

- a) Invalidët e aksidentuar në punë me trauma të kolonës vertebrale me pasojë paraplegji inferiore,
- b) invalidët e aksidentuar në punë me amputacion të një ekstremiteti inferior,

Nëse invalidi ka pasur një mjet për të cilin është çliruar nga dogana, mund të çlirohet nga detyrimi doganor edhe për një mjet tjetër kur vërtetohet nga organet kompetente (Drejtoritë e Policisë në rrethe) se mjeti i mëparshëm ka dalë jashtë përdorimit.

- c) invalidët e aksidentuar në punë me amputacion të dy ekstremiteteve inferiore,
 - d) invalidë me gjendje shëndetësore si a,b,c, rrjedhojë e një traume jashtë pune ose sëmundjeje të përgjithshme,
 - e) invalidët në pamundësi definitive për lëvizje (ecje) të pavarur, pavarësisht nga origjina e kësaj gjendjeje shëndetësore.
2. certifikatë lindjeje me fotografi (e vlefshme brenda muajit),
 3. dëshmi aftësie (për invalidët që kanë nevojë për mjete lëvizëse motorike),
 4. dokument të pronësisë së mjetit (akt blerje apo dhurimi te mjetit nga pronari, hartuar sipas kërkesave të kodit civil),
 5. vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për hyrjen e automjetit,
 6. dokumentacioni i mjetit.

Në ato raste kur mjetet lëvizëse dhe pajisjet ndihmëse sigurohen nga vete invalidët, në këtë rast invalidi çlirohet nga detyrimi doganor (mbështetur në nenin 8 pika 8.2 të Statusit të Invalidit të Punës) sipas procedurës së mëposhtme:

1. së pari duhet të depozitohet kërkesa e personit i cili gëzon statusin e invalidit dhe dokumentacioni i pronësisë apo pajisjes së mjetit përcillen zyrtarisht në ISSH nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
2. kërkesa regjistrohet dhe shqyrtohet brenda një muaji nga dorëzimi i saj së bashku me të gjitha dokumentet e nevojshëm. Afati pezullohet kur dokumentet kthehen për arsye të përligjura nga dispozitat ligjore apo rregulloret e posaçme. Për çdo rast bëhet shënimi përkatës në regjistër.
3. ISSH nëpërmjet organeve të specializuara shqyrton dokumentacionin e dërguar dhe i përgjigjet zyrtarisht Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave, nëse invalidi plotëson kushtet

Nëse invalidi ka pasur një mjet për të cilin është çliruar nga dogana, mund të çlirohet nga detyrimi doganor edhe për një mjet tjetër kur vërtetohet nga organet kompetente (Drejtoritë e Policisë në rrethe) se mjeti i mëparshëm ka dalë jashtë përdorimit. Për rastet që invalidi, për shkak të llojit dhe shkallës të aftësisë të kufizuar, nuk mund të drejtojë vetë automjetin, ai paraqet një prokurë të posaçme, të noterizuar, me të cilin autorizon për të drejtuar mjetin e tij një pjesëtar tjetër i familjes.

Kur nuk ka pjesëtar të familjes, me prokurë si më sipër, mund të autorizojë një të afërm. Në këtë rast paraqet edhe një certifikatë familjare si dhe dëshminë e aftësisë për drejtimin e mjetit. Invalidi përfitues paraqitet në DRSSH ku nënshkruan një kontratë me Drejtorinë e DRSSH –së.

Entila Zyba

Avokate, koordinatore programi prane FSHDPAK

E.B është 54 vjeçe nga qyteti i Elbasanit, nënë e katër fëmijëve. Si pasojë e një hematome të rëndë në pjesën e sistemit nervor ajo humbet aftësinë për të lëvizur.

Aktualisht ajo jeton nën përkujdesen e bashkëshortit e të fëmijëve. Ishte pikërisht bashkëshorti i saj i cili kërkoi ndihmën e Zyrës Ligjore në Elbasan për të përfituar pagesën e invaliditetit, pasi i ishin dashur muaj të tërë përpjekjesh për të plotësuar dokumentacionin e daljes në KMCAAP.

Me ndërhyrjen e zyrës ligjore në Elbasan u arrit që të realizohej plotësimi i dokumentacionit që nevojitej për përfitimin e KEMPIT, dhe për interes të të gjithë të interesuarve të cilët dalin për herë të parë në KMCAAP po bëjmë prezent si më poshtë dokumentet që nevojiten për përfitimin e pensionit të invaliditetit;

Dokumentet që duhet të plotësojnë invalidët kur dalin për herë të parë në KMCAAP, janë si më poshtë;

1. Certifikatë lindje me fotografi dhe certifikatë e gjendjes familjare.
2. Vërtetimi i periudhës së sigurimit (është i njëjtë si për pensionin e pleqërisë
3. Vërtetim për profesionin apo natyrën e punës (për punëmarrësin)
4. Raport mjekësor të gjendjes shëndetësore para periudhës së sigurimit.
5. Raport mjekësor i lirimit nga ushtria, lëshuar nga KMU pranë SQU, për ushtarët që bëhen invalidë gjatë shërbimit ushtarak.
6. Vërtetim për pagesën e paaftësisë për punë shkaktuar nga aksidente në punë/ sëmundje profesionale ose sëmundje të përgjithshme (për punëmarrësin në rast se aftësia e

kufizuar ka ndodhur gjatë marrëdhënieve të punës).

7. Fletë drejtimi për në KMCAAP, nga institucioni shëndetësor me shtretër, fletë dalje nga spitali.
8. Vërtetim i mesatares së bazës së vlerësueshme nga 01.01.1994 deri në ditën e lënies së punës.
9. Proces-verbal i aksidentit në punë.

Aktualisht E.B gëzon statusin e invalidit të punës dhe përfiton rregullisht pensionin e invaliditetit. Gjithashtu zj. E.B, në bazë të kërkesës të bërë në FSHDPAK, ka përfituar nga Punishte Mirësia, karrige me rrota, për ta lehtësuar lëvizjen e saj.

Av. Luiza Mema (Popja),
Koordinatorë e programit ligjor FSHDPAK, Elbasan

Prane FSHDPAK, kam arritur te gjej konsulence ligjore ne lidhje me trajtimin dhe sherbimin qe duhet te perfitojne personat me aftesi te kufizuar, pasi jo gjithmone jemi ne djeneri per ligjet qe miraton parlamenti shqiptar per keta persona...



Enisa Zifla,

vajza qe nuk rresht se kerkuari nga vetja dhe te tjeret per t'u integruar ne jeten sociale

Sot eshte nje vajze e rritur, e kendshme dhe mjaft terheqese per kedo qe e sheh per here te pare. Ne fakt kete vit ajo duhet te ishte si te gjitha bashkemoshataret duke studiuar ne nje nga fakultetet brenda apo jashte vendit, por demtimi qe ka pesuar ne tru gjate lindjes 19 vjet me pare, e kane kufizuar nga shume te drejta qe ajo duhej ti gezonte sot. E rreshtuar perkrah personave me aftesi te kufizuar mendore, ajo ka fatin e madh te ndodhet mes nje familjeje te perkushtuar ku prinderit bejne te pamunduren qe ajo te ndjehet e lumtur. E shoqeruar ne cdo moment nga perkujdesja e mamase se saj , ajo frekuenton cdo dite ambientet e nje qendre qe trajton personat me aftesi te kufizuar. E lidhur ngushte me kete qender per shkak te



shoqerise qe e rrethon dhe aktiviteteteve ku merr pjese , Enisa mezi prët qe te kaloje fundjava ne menyre qe dita e hene e javes se re, ta gjeje te rrethuar nga miqte dhe mesuesit e saj me te cilet ndan 6 oret e para te dites. Pertej ketij realiteti te veshtire dhe te dhimshem, babai i Enises , Kastriot Zifla, tregon se te rrisesh dhe ti sherbesh nje

femije me aftesi te kufizuar mendore ne vendin tone eshte nje sakrifice e madhe. Me deshperim ai pohon se kurre nuk e ka ndjere doren e shtetit ne mirerritjen e vajzes se tij, qofte edhe ne drejtim te marrjes se nje asistence kujdestarise per bashkeshorten. Zvarritjet burokraike neper zyrtar e njesise bashkiake nr.9, bene qe familja e tij ta injoroje qofte edhe kete ndihme minimale. Per Kastritoin, babain e Enises shpetimi i vajzes se tij dhe i te gjitha personave me aftesi te kufizuar vjen vetem atehere kur ata behen te pavarur ne jeten e tyre. Por kjo,- thote ai me keqardhje,- nuk ka per te ndodhur sa te jete ai gjalle. Pesimizmin per kete , ai e merr nga realiteti i veshtire ku jetojne personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi, ku



Askujt nuk do ti kushtonte asgje, qofshin keto institucione private apo shteterore, nese ne aktivitetet qe organizojne, te rezervojne disa karrige per pjesmarrjen e personave me aftesi te kufizuar, dhe kjo te jete nje detyrim ligjor, ne mos deshire

integrimi po behet i pamundur edhe per njerezit pa aftësi të kufizuar, shprehet ai, e jo me per femije si Enisa. Sipas Kastriotit, ajo nuk mund te jete e pavaruar ne veprimet e saj perderisa ne asnje institucion shteteror ku ata duhet te shkojne per te qare hallet, nuk ekziston infrastruktura e posacme per levizjet e tyre, perderisa jane te pakta apo gati te panjohura ambjentet ku jane te vendosura tabelat apo shenjat dalluese per ambiente te rezervuara per qendrimin e ketyre personave, kushte keto qe jane minimalja per integrimin e tyre ne shoqeri. Pesha e fatit te rene per pjese nuk e ka lene pasiv babain e Enises. Ai gjithmone eshte perpjekur ta integroje sado pak vajzen ne jeten shoqerore e sociale te vendit por mungesa e institucioneve arsimore, indiferenca e shtetit per ti ngritur ato dhe jo ne pak raste

edhe arroganca e njerezëve qe punojne ne ndonje prej tyre te mbetur ende ne kembe, e kane shtyre qe te behet pjese aktive e bordeve drejtuese te ngritura nga Fondacioni Shqiptar per te drejtat e personave me aftesi te kufizuara.

“Duke qene pjese aktive e aktiviteteve prane FSHDPAK, kam arritur te gjej konsulence ligjore ne lidhje me trajtimin dhe sherbimin qe duhet te perfitojne personat me aftesi te kufizuar, pasi jo gjithmone jemi ne djeni per ligjet qe miraton parlamenti shqiptar per keta persona. Ne mbledhjet e hepashershme qe organizon ky Fondacion, une si prind dhe familja ime arrijme te gjejme vendin tone ne raport me familje te tjera qe kane femije me aftesi te kufizuar. Ne kete fondacion ne marrim nje pamje rreale te gjendjes se

personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi”- keshtu shprehet Kastriot Zifla.

Pyetjes se cilat do te ishin disa nga sugjerimet e tij ne lidhje me permiresimin sado pak te jetes se ketyre personave ne nje kohe sa me te shpejte ai pergjigjet: “E para, do te doja qe te gjitha tu jepnin ketyre personave shansin per te marre pjese ne aktivitetet te jetes shoqerore. Askujt nuk do ti kushtonte asgje, qofshin keto institucione private apo shteterore, nese ne aktivitetet qe organizojne, te rezervojne disa karrige per pjesmarrjen e personave me aftesi te kufizuar, dhe kjo te jete nje detyrim ligjor, ne mos deshire. Autoritetet lokale duhet te nderhyjne urgjentisht ne arkitekturen e qyteteve per te krijuar disa lehtesia ne levizjen e ketyre personave. Qofshin keto rrampa ne trotuare apo në institucionet kryesore. Te organizohen tryeza, bashkebisedime e pse jo kontakte te drejteperdrejta me shtresa te ndryshme te shoqerise me qellim ndryshimin e mentalitetit shqiptar ne lidhje me trajtimin dhe respektimin e te drejtave te personave me aftesi te kufizuar. Roli i medias te jete me aktiv ne kete drejtim. Sensibilimi ndaj probleme qe ka kjo kategori e shoqerise shqiptare, do te ishte ne arme me shume ne duart tona si prinder per te luftuar te keqin, burokratin, indiferentin, dhe te shtirurit qe duket sikur kontribuojne por ne fakt nuk bejne asgje”.

Sonila Cemurati
gazetare